



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.06.2025

Numër Protokolli: 4225/2025

A.nr.653/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.653/2025 të datës 15.04.2024 të parashtruar nga ankuesi A.R, kundër organit të punësimit/Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë-Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “*vërejtje me shkrim*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.653/2025, e datës 15.04.2024, e parashtruar nga ankuesi, A.R, ashtu që **shfuqizohet** “*Vërejtja me shkrim*” e datës 03.03.2025, e Drejtorit Ekzekutiv të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** të organi i njëjtë.

II. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken I të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Nëpunësi civil, A.R (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 15.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2483/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.653/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër e-mailit të datës 03.03.2025, të Drejtorit Ekzekutiv të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, përmes të cilit e-mail të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm* Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (*tutje referuar vetëm* IKKL), ndërsa ky i fundit më datë 02.05.2025 ka përcjell përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3634/2025, të datës 29.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.653/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar* Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2483/2025 të datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vërejtjen me shkrim të datës 03.03.2025; Sqarimet profesionale të procedimit të pagesave, me e-mail të datës 27.02.2025; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 31.01.2025; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 02.05.2025; Akt emërimit me Nr.01/2024 të datës 01.09.2024; Vendimin Nr.589/2023 të datës 08.11.2023; Akt emërimit me Nr.14/2024 të datës 02.09.2024; E-mailin e datës 19.02.2025; E-mailin e datës 24.02.2025; Raportin javor të punës, të datës 24.02-28.02.2025; Formularin e certifikimit të dokumentacionit para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK, të datës 26.02.2025; Formularin e certifikimit të dokumentacionit para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK (pa datë dhe pa nënshkrim); Procesverbalin me numër protokolli 01/164 të datës 05.03.2025; Procesverbalin me numër protokolli 01/196 të datës 13.03.2025; Kërkesën për zgjidhjen e problemit të parkingut në institucionet shtetërore të datës me e-mail, prej 3 faqeve; E-mailin e datës 17.10.2024, me korrespondim prej 4 faqeve; Kërkesën për raporte të veçanta të datës 30.12.2024, me korrespondim prej 3 faqeve.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ***ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:***

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.01/2024, të datës 01.09.2024, është i punësuar në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme në IKKL, të cilin Drejtori Ekzekutiv i organit përkatës të punësimit, sipas e-mailit të datës 19.02.2025, për arsye të udhëtimit zyrtar deri më datë 28.02.2024, e ka autorizuar të njëjtin ta zëvendësoj për mbarëvajtjen e punëve në zyre.

Si rrjedhojë, Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së, pas pranimi të raportit javor të punës të datës 24.02-28.02.2025, të Zyrtares së Lartë Certifikuese, duke u bazuar në nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ankuesit përmes e-mailit të datës 03.03.2025, i ka shqiptuar masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, për shkak të shkeljes së nenit 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të këtij ligji, për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe toneve urdhëruese ndaj zyrtares në fjalë, si dhe për arsye se gjatë procesit të aprovimit të lëndës, zotimi/kërkesa e blerjes 2025-452, për aprovimin final në SIMFK, i njëjti ka bashkangjitur një “Formular të Certifikimit të Dokumentacionit Para Regjistrimit të Shpenzimit në SIMFK”, të dublifikuar.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vërejtja me shkrim e shqiptuar përmes e-mailit të datës 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së, është nxjerrë përmes shkeljeve të nenit 59, 61 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë, Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil si dhe nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ashtu që i njëjti i propozon Këshillit aprovimin e ankesës dhe anulimin e e-mailit të datës 03.03.2025.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, analizoi emailin e datës 03.03.2025, përmes të cilit Drejtorit i IKKL-së ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, dhe si rrjedhojë konstaton se i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase nuk ka strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, sipas paragrafi 1 të nenit 47 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.; dhe si i tillë konsiderohet i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë i njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr për bazë së respektimi i dispozitave procedurale është njeri ndër parakushtet kryesore për nxjerrjen e një akti administrativ të drejt dhe të ligjshëm, dhe meqenëse, me provat e administruara është vërtetuar se në rrethanat e rastit konkret, akti i kontestuar me ankesë është nxjerr përmes shkeljes së dispozitave procedurale, Kolegji i Këshillit, vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Vërejtjen me shkrim, të datës 03.03.2025, të Drejtorit Ekzekutiv të IKKL-së ,

dhe çështjen të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, me detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, duke eliminuar fillimisht shkeljet e konstatuara procedurale në kuptim të nxjerrjes së aktit administrativ në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe duke marrë për bazë se i njëjti në periudhën kur ka ndodhur rasti kontestues ka qenë në udhëtim zyrtar të konstatoj në mënyrë të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike, dhe të nxjerr vendim meritore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.653/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.R;
- Drejtorit Ekzekutiv dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.